

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

I nderuar zoti Leskaj, meqenëse folët më përpara, Nga fshati i nënës sime, që nuk besoj se është larg nga fshati i prindërve të tu, thonë: “Sa të të them më thua, më hodhe meret e tua”, dhe unë nuk e di se sa arrogant duhet të jesh që të flasësh me orë të tëra për diçka që është ende në hetim, nuk e di nëse duhet t’i vendosim brirë arrogancës... (Ndërhyrje pa mikrofon) Jo, jo, nuk e kam për rastin tuaj. Jam duke folur për të gjithë ju. Unë nuk e di nëse duhet t’i vendosim brirë arrogancës, kur pretendojmë se dimë diçka apo gjithçka për atë që është ende nën hetim! Arroganca ka këtë fytyrë. Kur diçka është duke u hetuar nga profesionistët, ti thua: “E di unë që ka ndodhur kështu”. Nga vjen kjo dhimbje? Nga vjen gjithë kjo shtysë? Vjen nga ky dokument. Ka ndodhur një betejë, në fakt, që është beteja e shqiptarëve me korrupsionin. Më 19 maj të vitit 2021, kur ju kishit dhimbjen e radhës, se kishit humbur për herë të tretë, ngaqë shqiptarët nuk jua kishin dhënë besimin, një muaj më pas juve ju ndodh dhimbja më e madhe, nga e cila ende nuk po e merrni veten. Sot jeni përpara shqiptarëve tërësisht në një pozicion që, dhe po t’ua tregonit, nuk do ta besonin. Po lexoj deklaratën e Sekretarit Amerikan të Shtetit, Antony Blinken: “Sot unë shpall përcaktimin publik të Sali Berishës, ish-President i Shqipërisë, ish-Kryeministër i Shqipërisë... (Ndërhyrje pa mikrofon) Me ngadalë, se ju dëgjova me vëmendje! Prit, se sapo kam filluar! ...dhe ish-deputet i parlamentit të Shqipërisë, për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion domethënës. Në cilësinë e tij zyrtare, veçanërisht si Kryeministër i Shqipërisë... (Ndërhyrje pa mikrofon) Me ngadalë! Ti votove atëherë, që të ikte nga grupi, apo jo? ...Berisha ishte i përfshirë në veprime korruptive të tilla, si: shpërdorim të fondeve publike; ndërhyrje në proceset publike, përfshirë përdorimin e pushtetit për përfitime personale. Ai është i gatshëm të mbrojë veten, anëtarët e familjes tij dhe aleatët e tij politikë në kurriz të hetimeve të pavarura”. Kjo është dhimbja, të nderuar qytetarë, që na ndiqni sot; kjo është dhimbja që i ka çuar turrarendës në gjetjen e fajtorit. Imagjinoni, në atë aksident të frikshëm në mes të Tiranës, për ata që u tronditën e u vranë atje, se u ra autobusi, në vend të kërkonin doktorin, të thoshin: “Kush është fajtori?”! Vetëm ju e bëni këtë gjë, doni të gjeni fajtorin dhe keni një vit e gjysmë në kërkim të fajtorit. Dhe ku e kuptojmë këtë gjë? E kuptojmë te zemërimi i atij njeriu, tek tërbimi i atij njeriu, sepse ai e kupton fare mirë që nuk ka kohë. Nuk ka kohë dhe mundësi. I ka shumë të vogla edhe kohën, edhe mundësinë.

Është shumë e thjeshtë të kuptosh zemërimin dhe tërbimin e atij njeriu, sepse u ngrit nga mesi i asaj salle në vendin e nderuar, ku ishte pas kësaj damkosjeje, dhe shkoi në fund. Pra, edhe hapësirën nuk e ka më. Gjysma juaj nuk e pranon më si të vetin, si prijësin e vet, ndërkohë që treçereku i shqiptarëve, jo vetëm treçereku, por edhe shumë më shumë, sepse vetëm 10 mijë po i shkojnë nga mbrapa, tashmë nuk e njohin më (është turpi i tyre dhe e dinë shumë mirë) për shkak të kësaj. Ndaj paditësi i lashtë i socialistëve u ndez në zemërim. Ato stërkala dhe spërkatje zemërimi ju po i shikoni sot këtu, sepse

kanë mbetur te disa të tjerë, sepse ish-sekretari i partisë nuk e drejton dot revolucionin pa armiq, i duhen armiq, i duhen “titistë”, i duhen “hrushovjanë”, i duhen kinezë dhe gjithmonë i duhet të shpallë armiq, pra, përveç Kryeministrit të Shqipërisë që e ka armikun e përditshëm, ka gjetur edhe armiq të rinj. Kësaj radhe këta janë armiq të vërtetë të tij. Këtyre s’ka çfarë t’u bëjë. Këtu ka mbaruar beteja. Këtyre s’keni çfarë t’u bëni edhe ju. Ndaj paditësi dhe paditësit po pandehin të gjithë për gjithçka. Shikoni deri ku kanë arritur! Sekretari Amerikan i Shtetit pandehet se nuk kupton gjë; e marrin përdore dhe këto gjërat ia shkruajnë ca njerëz dhe ai nuk e di se çfarë bën dhe sesi korifeun e drejtësisë, korifeun e demokracisë e shpalli të padëshirueshëm për këto gjëra që unë sapo lexova, sepse ku merr vesh ai! Pandehet Sekretari Amerikan i Shtetit! Pandehet ambasadorja fuqiptotë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si gjobaxhie! Ju e pandehni ambasadorin e SHBA-së si gjobaxhie! Ai paditësi i madh, ai paditësi i lashtë i socialistëve jua ka mbyllur sytë dhe i shkoni nga mbrapa dhe pandehni se një ambasadore e nderuar, që bën detyrën e saj, është gjobaxhie, u vë gjoba bizneseve shqiptare. I thoni vetë, i botoni në anglisht dhe pastaj i lexoni sikur të jenë të vërteta të mëdha. Edhe prokurorët amerikanë ju i pandehni si të paaftë, të paaftë që nuk ndajnë dot korrupsionin, të korruptuarin dhe korruptuesin, ose, nëse do ta shqipërojmë fjalën “korrupsion”, kalbëzimin, të kalbëzuarin dhe kalbësirën. Prokurorët amerikanë nuk e dallojnë dot këtë! Janë të paaftë ta kuptojnë këtë gjë dhe si pasojë po i ndihmoni ju! Jeni vënë të gjithë asistentë ligjorë të prokurorëve amerikanë dhe po i ndihmoni ata të kuptojnë korrupsionin madhor, të kuptojnë hedhjen në erë të demokracisë shqiptare, të kuptojnë se si ndërhyhet në sistemin gjyqësor me protestë dhe pa protestë. Po i ndihmoni ju! Ndërkohë që keni vetëm një zgjedhje, të cilën s’po e bëni. Keni një vit e gjysmë që përpëliteni dhe përpëliteni, por nuk po e bëni. E nisi një pjesë juaja, një pjesë e kolegëve, të cilëve unë u heq kapelën, ata kolegë që nuk kanë dalë nga ai istikam.. Po patjetër, ne e ndihmojmë njeri-tjetrin, sepse jemi kolegë. Patjetër që e bëjmë këtë gjë, sepse më dhimbsen. Kam dëgjuar një histori që ka rrëfyer zotëria non grata, një histori nga jeta e tij, ku thoshte: “Lehte një qen dhe unë isha shumë i shqetësuar. Shkoja pas qenit dhe s’e pushoja dot derisa më tha gjyshja: Sali, mos u merr me qenin, se do të të çmendë qeni”. Dhe është shumë interesante se si shmangia e fajit lulëzon që nga fëmijëria, shmangia e fajit dhe gjetja e fajit tek tjetri fillon që nga fëmijëria. Ka ndjekur këshillën e gjyshes dhe ka ikur në drejtim të gabuar. E shkreta, ka dashur ta ndihmonte atë natë që të flinte, por e ka lënë pa gjumë një jetë të tërë, sepse ai nuk ballafaqohet me veten, edhe ju nuk ballafaqoheni me veten tuaj dhe doni të drejtoni shqiptarët. Drejtimi kërkon të bëni dy gjëra: llogaridhënie dhe transparencë.